

20200100203

LIGJ PËR PJESËMARRJEN E TË RINJVE DHE POLITIKAT E TË RINJVE

Kreu I.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e ligjit

Neni 1

Lëndë e rregullimit të këtij ligji janë format e organizimit të të rinjve, pjesëmarrja e të rinjve në procesin e krijimit të politikave të të rinjve dhe miratimi i vendimeve të cilat kanë të bëjnë me ta, dokumentet strategjike në nivel nacional dhe lokal, aktivitetet dhe masat të cilat i ndërmarrin organet e administratës shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale për avancimin e pozitës së të rinjve në shoqëri, si dhe informimi dhe planifikimi i përbashkët i aktiviteteve të lidhura me të rinjtë dhe për të rinjtë.

Qëllimi i ligjit

Neni 2

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë:

- 1) krijimin dhe zbatimin e politikave të të rinjve në të gjitha nivelet nëpërmjet qasjes shumësektoriale, duke u nisur nga nevojat dhe interesat e të rinjve;
- 2) përforsimin e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e krijimit të politikave për të rinj, informimin, promovimin dhe mbrojtjen aktive të interesave të të rinjve, si dhe përforsimin e vetëdijes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror;
- 3) promovimin e partneritetit të ndërgjeneratave për mbështetjen e pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e miratimit të vendimeve dhe politikave;
- 4) mbështetjen dhe avancimin e organizimit të të rinjve;
- 5) nxitjen e dialogut strukturor në nivel nacional dhe lokal;
- 6) nxitjen e volonterisë, aktivizimit të të rinjve dhe punës së të rinjve dhe
- 7) nxitjen e zhvillimit personal, social dhe profesional të të rinjtë.

Definicione

Neni 3

Shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

- 1) “të rinj” janë persona në moshën nga 15 deri në 29 vjet;
- 2) “politika e të rinjve” është përmbledhje e masave dhe aktiviteteve të cilat ndërmerren që të plotësohen nevojat e të rinjve, me qëllim të realizimit të potencialit të plotë të tyre;
- 3) “pjesëmarrje e të rinjve” paraqet proces i cili u mundëson të rinjve pjesëmarrje dhe marrje të përbashkët të vendimeve për politika dhe programe të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi e formojnë jetën e të rinjve;
- 4) “punë e të rinjve” paraqet proces të organizuar dhe sistematik të edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit autentik të të rinjve me qëllim të realizimit të potencialit të tyre të plotë personal, social dhe shoqëror dhe përfshirjen e tyre aktive në jetën e bashkësisë;

5) "punëtorë të të rinjve" janë persona të kualifikuar të cilët posedojnë kompetenca për punë me persona të rinj duke realizuar aktivitete me të cilat mbështetet zhvillimi i tyre personal dhe social përmes mësimi joformal dhe informal.

Neni 4

Shprehjet e përdorura në këtë ligj të cilat janë të përcaktuara në bazë gjinore, shfrytëzohen në mënyrë neutrale dhe kanë të bëjnë njëloj me persona të gjinisë mashkullore dhe femërore.

Neni 5

(1) Parime themelore në të cilat bazohet ky ligj janë, parimi ipërfshirjes dh lidhjes ndëretnike:

- 1) barazisë, mundësive të barabarta dhe ndalimit nga diskriminimi;
- 2) pavarësisë, pluralizmit dhe demokracisë në të gjitha format e organizimit të të rinjve;
- 3) transparencës dhe publicitetit;
- 4) ngritjes së vetëdijes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror;
- 5) multikulturalizimit, interkulturalizimit dhe përfshirjes në pjesëmarrjen aktive të të rinjve;
- 6) përfshirjes dhe lidhjes ndëretnike të organizimit të të rinjve dhe udhëheqjes së politikave publike të të rinjve;

7) përgjegjësisë dhe solidaritetit te të rinjtë dhe

8) bashkëpunimit ndërinstitucional në krijimin dhe zbatimin e politikave të të rinjve.

(2) Të gjitha format e organizimit të të rinjve, si dhe organet e administratës shtetërore, në veprimin dhe aktivitetet që kanë të bëjnë me të rinjtë do t'i përmbahen parimeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

Kreu II.

FORMA TË ORGANIZIMIT DHE PËRFAQËSIMIT TË TË RINJVE

Organizata e të rinjve

Neni 6

Organizatë e të rinjve është çdo organizatë e cila është regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, në të cilin trupi më i lartë i vendosjes është i përbërë nga së paku dy të tretat persona të rinj të moshës nga 15 deri në 29 vjet dhe qëllimet dhe aktivitetet e të cilëve janë definuar dhe orientuar drejt avancimit të interesave të të rinjve.

Organizata për të rinj

Neni 7

Organizatë për të rinj është çdo organizatë e regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione, e cila nuk është e udhëhequr nga të rinj, ose është rini e partisë politike, seksion i rinisë në sindikat e organizuar si pjesë e subjektit tjetër juridik, pjesë e qëllimeve dhe aktiviteteve programore të të cilave janë të drejtuara në avancimin e interesave të të rinjve.

Organizata ombrellë të të rinjve

Neni 8

(1) Organizatat ombrellë të të rinjve janë organizata në të cilat marrin pjesë format e organizimit të të rinjve të cilat bashkohen për realizimin e qëllimeve të përbashkëta në sfera specifike me interes të të rinjve.

- (2) Organizata ombrellë e të rinjve duhet:
- të ketë së paku dhjetë anëtare nga së paku pesë rajone të planit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
 - të ketë dy të tretat të rinj në organin më të lartë të udhëheqjes dhe
 - të jetë e regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata dhe fondacione.
- (3) Organizata ombrellë e të rinjve ka statutin e vet.

Neni 9

- Organizatata ombrellë të të rinjve mund të:
- marrin pjesë në procesin e krijimit të ligjeve, dokumenteve për politika dhe dokumenteve tjera strategjike nga sfera në të cilën veprojnë,
 - marrin pjesë në zbatimin, ndjekjen dhe vlerësimin e politikave për të rinj në sferat në të cilat veprojnë,
 - mbështesin organizimin dhe shoqërimin e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
 - i përfaqësojnë qëllimet e përbashkëta në sferat e posaçme në të cilat veprojnë me interes për të rinjtë,
 - propozojnë masa ndaj bartësve të vendimeve në sferat në të cilat veprojnë,
 - zbatojnë analiza dhe hulumtime në lidhje me zhvillimin e të rinjve në shoqëri dhe
 - zbatojnë aktivitete të mundësuar me këtë Ligj, akte tjera nënligjore dhe Statutin e organizatës.

Asambleja Nacionale e të Rinjve

Neni 10

- (1) Asambleja Nacionale e të Rinjve paraqet trup të formave të organizimit të të rinjve i cili bën zgjedhje të përfaqësuesve të të rinjve në trupin këshillëdhënës, krijon prioritete dhe politika për përfaqësimin e përfaqësuesve të të rinjve dhe e koordinon dhe ndjek punën e tyre (në tekstin e mëtejme: Asambleja e të Rinjve).
- (2) Asambleja e të rinjve punën e vet e rregullon me Rregullore.

Neni 11

- (1) Asamblenë e të Rinjve e cakton këshilli iniciues nga së paku një e treta e formave të organizimit të të rinjve nga Regjistri.
- (2) Këshilli iniciues obligohet detyrimisht t'i njoftojë të gjitha format e organizimit të të rinjve nga Regjistri për mbajtjen e mbledhjeve të Asamblesë së të Rinjve.
- (3) Asambleja e të Rinjve mbahet së paku një herë në vit.
- (4) Me kërkesë të një të tretës së formave të organizimit të të rinjve nga Regjistri si dhe me kërkesë të dy të tretave të përfaqësuesve të të rinjve konvokohet mbledhja të Asamblesë së të Rinjve.
- (5) Shpenzimet operative për organizim të asambleve pas planit financiar paraprakisht të dorëzuar, financohen nga mjetet e siguruara në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga organi kompetent i administratës shtetërore kompetent për punët nga sfera e të rinjve.

Neni 12

- Fushëveprimi i punës së Asamblesë së të Rinjve përbëhet nga:
- zgjedhja e përfaqësuesve të të rinjve në trupin këshillëdhënës,
 - krijimi i politikave dhe prioriteteve,
 - ndjekja e punës së përfaqësuesve të të rinjve,
 - shqyrtimi i raporteve të përfaqësuesve të të rinjve dhe
 - aktivitete tjera në pajtim me këtë ligj dhe rregullore.

Kreu III.

REGJISTRIT I FORMAVE TË ORGANIZIMIT TË TË RINJVE

Neni 13

(1) Regjistrin e organizatave të të rinjve dhe organizatat për të rinj e udhëheq Agjencia e Rinisë dhe Sportit.

(2) Gjatë regjistrimit në regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, organizatat janë të detyruara te Agjencia e Rinisë dhe Sportit të dorëzojnë:

- kërkesë për regjistrim në regjistër,
- aktvendim për regjistrim të kryer në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilin vërtetohet se organizata është themeluar së paku një vit,
- gjenden rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetër se gjashtë muaj me të cilën vërtetohet statusi aktiv i organizatave
- statutin e organizatës,
- programin për punë të organizatës,
- raport vjetor të aktiviteteve nga sfera e të rinjve,
- numrin e përgjithshëm të anëtarëve të organizatës dhe
- numrin e anëtarëve nga 15 deri në 29 vjet.

(3) Për organizatat për të rinj nga neni 7 i këtij ligji, nuk kërkohen dokumentet nga paragrafi (2) alinetë 2 dhe 3 të këtij neni.

(4) Agjencia e Rinisë dhe Sportit miraton aktvendim për regjistrim në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për regjistrim në regjistër.

(5) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit i përcakton Agjencia e Rinisë dhe Sportit.

(6) Agjencia e Rinisë dhe Sportit e azhurnon regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, më së voni deri më 30 qershor në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(7) Regjistri është publik dhe është i kapshëm në ueb faqen e Agjencisë së Rinisë dhe Sportit.

Kreu IV.

PJESËMARRJA E TË RINJVE

Trupi Nacional Këshillëdhënës për Politikën e të Rinjve

Neni 14

(1) Trupi Nacional Këshillëdhënës për Politikën e të Rinjve (në tekstin e mëtejshëm: trupi këshillëdhënës) është trup për bashkëpunim ndërmjet përfaqësuesve të të rinjve dhe përfaqësuesve të organeve të administratës shtetërore i cili ka rol këshillëdhënës dhe mbikëqyrës, gjatë zbatimit të politikave të të rinjve dhe aktiviteteve për të rinj.

(2) Trupi Këshillëdhënës formohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Trupi Këshillëdhënës është i përbërë nga përfaqësues të emëruar nga organet e administratës shtetërore, por jo më shumë se tetë anëtarë dhe nëntë përfaqësues të të rinjve të zgjedhur nga Kuvendi Nacional i të Rinjve, nga të cilët njëri është kryetar.

(4) Anëtarët e emëruar nga organet e administratës shtetërore kanë mandat prej dy vitesh me të drejtë edhe të një zgjedhjeje. Përfaqësuesit e të rinjve të zgjedhur nga trupi përfaqësues kanë mandat prej dy vitesh me të drejtë edhe të një zgjedhjeje.

(5) Trupi Këshillëdhënës ka rregullore për punë.

(6) Mbështetje administrative, financiare dhe logjistike për punën e Trupit Këshillëdhënës siguron Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 15

(1) Trupi Nacional Këshillëdhënës për Politikën e të rinjve nga neni 14 i këtij ligji, i ka këto kompetenca:

- jep mendime dhe rekomandime për zbatim të dispozitave dhe politikave të të rinjve,
- jep mendim për Strategjinë nacionale për të rinj dhe për planin aksional për zbatimin e Strategjisë nacionale për të rinj,
- jep mendim për mjetet buxhetore të dedikuara për të rinj si dhe propozime, mendime dhe rekomandime për financimin e aktiviteteve të lidhura me të rinjtë,
- inicion shqyrtim të çështjeve për të rinj në Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- propozon vendosjen e mekanizmave për vlerësim të pjesëmarrjes së të rinjve dhe realizimin e interesave të të rinjve në jetën shoqërore,
- publikon raporte (tematike dhe periodike) për të drejtat, mundësitë dhe nevojat e të rinjve në Republikën e Maqedonisë së Veriut,
- i ndjek rekomandimet e Bashkimit Evropian për të rinjtë dhe angazhohet për përmirësimin e politikave për të rinjtë,
- organizon ngjarje dhe konsultime për punën e vet me organizatat e të rinjve dhe të rinjtë dhe
- kryen punë të tjera lidhur me të rinjtë dhe interesat e tyre, në pajtim me këtë ligj dhe rregulloren për punë nga neni 14 paragrafi (5) i këtij ligji.

Kreu V.

KËSHILLAT LOKALË TË TË RINJVE

Formimi i këshillave lokalë të të rinjve

Neni 16

(1) Komunitat, komunitat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit me statut parashohin formim të këshillave lokalë të të rinjve.

(2) Këshillat lokalë të të rinjve kanë rol këshillëdhënës dhe përfaqësues në komuna, komuna në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit nga fushëveprimi i çështjeve dhe politikave të të rinjve.

(3) Përfaqësuesit e këshillave lokalë të të rinjve kanë të drejtë të:

- propozojnë pika të rendit të ditës të Këshillit të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit të cilat i tangojnë të rinjtë,
- iniciojnë çështje për të rinjtë nga fushëveprimi i punës së komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe të qytetit të Shkupit,
- iniciojnë, marrin pjesë dhe japin informata kthyesë për procesin e strategjisë lokale të të rinjve dhe politika të tjera,
- dorëzojnë informata për komunitat, komunitat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit për çështje të cilat kanë të bëjnë me të rinjtë dhe
- kryejnë punë të tjera këshillëdhënëse dhe përfaqësuese në pajtim me këtë ligj.

(4) Numri i anëtarëve të këshillave lokalë të të rinjve është tek dhe nuk e tejkalon më shumë se një të tretën e anëtarëve të Këshillit të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, por nuk mund të jetë më pak se pesë persona.

(5) Anëtarët e këshillave lokalë të të rinjve kanë mandat prej dy vitesh me të drejtë edhe të një zgjedhjeje.

Asambleja Lokale e të Rinjve

Neni 17

(1) Për konsituimin e asamblesë lokale për të rinj thirret këshilli inicues, i përbërë nga format e paraqitura në paragrafin (4) të këtij neni.

(2) Këshilli inicues e shpall thirrjen për asamblenë lokale konstituive për të rinj në pajtim me Statutin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit sipas parimit të transparencës dhe publcitetit.

(3) Këshilli inicues nga paragrafi (2) i këtij neni formohet vetëm për mbajtje të asamblesë konstituive lokale për të rinjtë.

(4) Në Asamblenë e të Rinjve mund të anëtarësohen organizata të të rinjve, organizata për të rinj, breza të rinj politike, organizata të nxënësve dhe studentëve dhe forma tjera të bashkimit të të rinjve.

(5) Format e organizimit dhe shoqërimit nga paragrafi (4) i këtij neni nuk është e domosdoshme të jenë të regjistruara në komuna, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit, por doemos duhet të kenë aktivitete në territorin e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit në Asamblenë e së cilës anëtarësohen.

(6) Format e organizimit të cilat anëtarësohen në asamblenë vjetore për të rinj nominojnë delegat dhe zëvendësdelegat.

(7) Delegati dhe zëvendësdelegati nga paragrafi (6) i këtij neni, është banor i komunës, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit në moshë prej 15 deri në 29 vjet.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Lokal të të Rinjve

Neni 18

(1) Asambleja e të rinjve shpall thirrje publike për anëtarët e Këshillit Lokal të të Rinjve.

(2) Thirrja publike do të publikohet në ueb-faqen e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit.

(3) Asambleja e të Rinjve zgjedh anëtarë të Këshillit Lokal të të Rinjve me zgjedhje të drejtpërdrejtë me votim të fshehtë në të cilin kanë të drejtë të votojnë delegatët e Asamblesë Lokale të të Rinjve.

(4) Për anëtarët e zgjedhur të Këshillit Lokal të të Rinjve konsiderohen ata kandidatë që kanë fituar më së shumti vota nga delegatët e pranishëm.

(5) Anëtarët e këshillave lokale të të rinjve të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, verifikohen nga Këshilli i Komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit pas vendimit të marrë për zgjedhje të anëtarëve nga Asambleja e të Rinjve të komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(6) Nga anëtarët e zgjedhur të Këshillit Lokal të të Rinjve zgjidhet kryetari dhe nënkryetari.

Kreu VI.

POLITIKA E TË RINJËVE

Strategjia nacionale e të rinjve

Neni 19

(1) Strategjia nacionale e të rinjve është dokument strategjik me të cilin përcaktohen qëllimet dhe përparësitë afatmesme për zhvillimin e politikave të të rinjve dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe përcaktohen masa organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre.

(2) Strategjia nacionale përmban edhe Plan aksional për realizim me aktivitete, dinamikë të definuar, bartës të aktiviteteve dhe projekte të mjeteve buxhetore, si dhe kushte dhe indikatorë për evalvim për zbatimin e Strategjisë nacionale të të rinjve.

(3) Strategjinë nacionale të të rinjve e miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhë prej pesë vitesh.

(4) Strategjinë nacionale të të rinjve e përpilon Agjencia e Rinisë dhe Sportit përmes procesit këshillues, gjithëpërfshirës dhe transparent dhe me mendimin paraprak të marrë nga trupi këshillues për të rinj dhe ia dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Planet aksionale për Strategjinë nacionale të të rinjve përpunohen nga Agjencia e Rinisë dhe Sportit me mendim paraprak të marrë nga Trupi Këshillëdhënës Nacional i të Rinjve dhe i dorëzon në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën nga një deri tre vjet dhe për ato parashtron buxhet për realizim.

(6) Planet aksionale i miraton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(7) Strategjia nacionale e të rinjve zbatohet me mjete financiare nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(8) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përgatit raport vjetor për zbatimin e Strategjisë nacionale të të rinjve dhe planit aksional të cilin e shqyrton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut më së voni deri më 30 qershor në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

Strategjia lokale e të rinjve

Neni 20

(1) Strategjia lokale e të rinjëve është dokument strategjik me të cilin, në pajtim me Strategjinë nacionale të të rinjve, përcaktohen qëllimet dhe përparësitë afatmesme për zhvillimin e politikave të të rinjve dhe promovimin e interesave të të rinjve dhe përcaktohen masa organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tyre.

(2) Strategjia lokale përmban edhe Plan aksional për realizim me aktivitete, dinamikë të definuara, bartës të aktiviteteve dhe projekte të mjeteve buxhetore, si dhe kushte dhe indikatorë për evalvimin e zbatimit të Strategjisë lokale të të rinjve.

(3) Strategjinë lokale të të rinjve e miraton Këshilli i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit për periudhë prej pesë vitesh.

(4) Strategjia lokale e të rinjve përpunohet nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Këshillin Lokal të të Rinjve.

(5) Planet aksionale për strategjinë lokale të të rinjve përpunohen nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në bashkëpunim me Këshillin Lokal të të Rinjve, ndërsa e miraton këshilli i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në periudhën prej një viti deri në tre vite dhe për to parashtrahet dhe buxhet për realizim.

(6) Strategjia lokale e të rinjve zbatohet me mjete buxhetore nga komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit

Kreu VII.

SERVISE PËR TË RINJ

Zyra për të rinj

Neni 21

Komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit formojnë zyra për të rinj nga ku koordinohet puna për të rinj në komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit dhe paraqet pikë primare për qasje për të rinj në nivel lokal.

Qendra për të rinj

Neni 22

(1) Qendrat për të rinj janë vende ku përgatiten dhe zbatohen programe që e përmirësojnë mirëqenien e të rinjve, zhvillimin e jetës personale, sociale dhe profesionale të të rinjve, informacione me interes të rëndësishëm për të rinj dhe aspekte të tjera nga jeta të rinjve.

(2) Për punë me të rinj në qendrat për të rinj përgjegjës janë punëtorët e të rinjve.

(3) Qendrat e të rinjve themelohen në bashkëpunim ndërmjet komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetin e Shkupit dhe format e të rinjve të organizimit të rregulluara me këtë ligj.

Nëpunës për të rinj

Neni 23

(1) Organet e administratës shtetërore, komunat, komunat në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar të caktojnë administrator për të rinj, person përgjegjës për punën e Zyrës për koordinim, zbatim dhe përcjelljen e çështjeve me interes të të rinjve në fushëveprimin e kompetencave të institucionit.

(2) Nëpunësit për të rinj nga paragrafi (1) i këtij neni, përgatisin raport vjetor për punën e institucioneve në fushëveprimin e të rinjve që i parashirojnë te Agjencia e Rinisë dhe Sportit dhe i publikojnë në ueb-faqen e organeve të administratës shtetërore, komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

(3) Informatat për kontakt për nëpunësit për të rinj nga paragrafi (1) i këtij neni janë të arritshme publikisht nëpërmjet gazetave të organeve të administratës shtetërore, komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit.

Neni 24

Agjencia e Rinisë dhe Sportit themelon qendër hulumtuese për tema të ndryshme të lidhura me të rinjtë.

Kreu VIII.

FINANCIMI

Neni 25

(1) Për zbatimin e këtij ligji nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vit ndahen mjete në lartësi prej së paku 0,3%.

(2) Nga buxhetet e komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit për të rinjtë ndahen së paku 0,1% në nivel vjetor.

Kreu IX.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

(1) Rregullat nënligjore me të cilat rregullohen forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrit të përcaktuar me këtë ligj, Agjencia e Rinisë dhe Sportit do t'i miratojë në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Agjencia e Rinisë dhe Sportit në afat prej 30 ditësh nga miralimi i aktit nënligjor nga paragrafi (1), e vendos regjistrin në forma të organizimit të të rinjve.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 18 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton Strategji nacionale për të rinj në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(4) Komunitet, komunitet në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit formon zyra për të rinj më së voni 90 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(5) Organet e administratës shtetërore, komunitet, komunitet në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përcaktojnë nëpunës për të rinj.

(6) Në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, formohen këshillat lokalë të të rinjve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, ndërsa këshillat lokalë ekzistuese të të rinjve të cilëve nuk u ka kaluar mandati, transformohen në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(7) Në afat prej pesë vitesh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, secila komunë duhet të mundësojë funksionim të së paku një qendre të të rinjve në territorin e komunës.

(8) Në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, themelohet qendra hulumtuese për tema të ndryshme të lidhura me të rinjtë në kuadër të Agjencisë së Rinisë dhe Sportit.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".